



CIMC-2008/01

Sipas Nenit 16 të ligjit Nr. 02/L-15 mbi Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media ka aprovuar

Vendim

**për nivelin, mënyrën e përcaktimit të pagesës të taksës për Licencë të
Radios dhe TV-së**

Neni 1

Përbajtja e Vendimit

Ky vendim do të rregullojë:

- 1.1. Nivelin e taksës së vetme për regjistrim të tenderit në lidhje me aplikacionet për licencë të transmetimit analog tokësor dhe sinjalit të radios.
- 1.2. Nivelin e taksës së vetme për aktivitetet në lidhje me regjistrimin e aplikuesit për lëshim, ndryshim apo vazhdim të licencës për transmetim analog tokësor dhe/ose transmetim të sinjaleve të radios dhe televizive.
- 1.3. Nivelin, mënyrën e përcaktimit të pagesës së taksës vjetore për licencë analoge tokësore dhe transmetim të sinjaleve televizive dhe të radios;

Neni 2

Niveli i taksës së vetme administrative për regjistrim të aplikacioneve të tenderit

- 2.1. Taksa e vetme administrative do të ngarkohet për regjistrim të aplikacioneve të tenderit, nivelet e të cilave do të përcaktohen sipas llojit të aktivitetit të transmetimit dhe madhësisë së zonës ku aktivitetit ushtrohet.
- 2.2. Kjo takse administrative do t'i paguhet Komisionit të Pavarur për Media gjatë paraqitjes së aplikacionit të tenderit, pa mundësi të kthimit të taksës.

Ruga Gëzmand Zajmi #1, Prishtina - Gazmend Zajmi Street #1, Pristina - Ulica Gazmend Zajmi #1, Priština

t. +381 (0)38 245 031 f. +381 (0)38 245 034 e. info@imc-ko.org

2.3. Niveli i kësaj takse administrative të Licencës do të përcaktohet në një vendim të veçantë.

Neni 3

Niveli i taksës së vetme të regjistrimit

3.1. Një taksë e vetme për regjistrim të personit fizik apo juridik i cili ka fituar të drejtën për transmetim, si edhe personat të cilët i vazhdojnë licencat e tyre do të ngarkohen sipas shpenzimeve të dispozitave të licencës për transmetim, vlerësimit teknik dhe regjistrimit nga Komisioni i Pavarur për Media.

Niveli i taksës së vetme të regjistrimit është për

- Radio: 10% e taksës vjetore e përshtatshme për subjektin e caktuar transmetues
- Televizion: 10% e taksës vjetore e përshtatshme për subjektin e caktuar transmetues

3.2. Gjatë paraqitjes së aplikacionit për licencë të përkohshme, do të paguhet një taksë në vlerë prej 10% e taksës së vetme vjetore. Gjatë paraqitjes së aplikacionit, një taksë e vetme e regjistrimit do t'i paguhet Komisionit të Pavarur për Media, pa mundësi të kthimit.

Neni 4

Kriteret e Vlerësimit të Taksës Vjetore

Taksa Vjetore për transmetim të sinjaleve të radios dhe televizonit do të përcaktohet në bazë të:

- të hyrave të përgjithshme vjetore të deklaruara nga subjektet transmetuese;
- numrit të popullatës në zonën e caktuar të mbulimit;
- llojit të subjektit transmetues (radio apo TV);
- kategorisë së subjektit transmetues.

Neni 5

Mënyra dhe Llogaritja e Nivelit të Taksës Vjetore

Formula

Për përcaktimin e nivelit të taksës për licencë KPM aplikon procedurat vijuese për të përcaktuar shumën e taksës për licencë ashtu siç parashihet me Nenin 16.1 të ligjit të KPM-së.

Faza 1: Llogaritja e taksës për Licencë për secilin subjekt transmetues do të llogaritet në bazë të formulës si në vijim:

Ruga Gazmend Zajmi #1, Prishtina - Gazmend Zajmi Street #1, Pristina - Ulica Gazmend Zajmi #1, Priština

t. +381 (0)38 245 031 f. +381 (0)38 245 034 e. info@imc-ko.org

$$A \times B \times C \times D \times 12 = \text{shuma}$$

A - Vlera bazë e shprehur

Vlera bazë është e mbështetur në llogaritjen e kostos për prodhim të programit për një orë. Llogaritja është bërë duke u bazuar në mesataren e të hyrave të përgjithshme vjetore të deklaruara për vitin 2007 nga të gjitha subjektet transmetuese të licencuara në Kosovë, përfshirë të gjitha kategoritë.

A = 19 Euro

B - Koeficienti i mbulueshmërisë

Koeficienti B është i bazuar në numrin e banorëve që jetojnë në zonën e mbulimit të subjektit transmetues. Duke marrë parasysh numrin e përgjithshëm të banorëve të Kosovës 2,200,000 ky faktor do të marrë vlerën varësisht nga zona e mbulimit. Të dhënat për shtrirjen e popullsisë në Kosovë janë marrë nga Ministria për Ekonomi dhe Financa.

B = 1 njësi = 100.000 banorë

Koeficienti **0.05** është përcaktuar për subjektet transmetuese që transmetojnë me fuqi të ulët për të cilat mungojnë të dhënat e numrit të popullsisë nga dokumenti i MEF-it, kështu që në përcaktimin e këtij koeficienti është marrë për bazë Komuna e Novobërdës e cila përbëhet prej 5.000 banorëve.

Për mediat nacionale koeficienti B është llogaritur 17 (e jo 22 si do të duhej të ishte sipas asaj 1 njësi = 100.000 banorë për faktin që këto media nuk mbulojnë tërë territorin e Kosovës).

C - Koeficienti i llojit të subjektit transmetues

Koeficienti C është i bazuar varësisht nga lloji i subjektit transmetues duke marrë vlera respektive:

Radio	1.00
Televizion	1.50

D – Koeficienti i Kategorizimit

Koeficienti D është i bazuar në kategorizim varësisht nga kategoria e subjektit transmetues:

- Koeficienti i subjektit transmetues me fuqi të ulët do të jetë i barabartë me 1;
- Koeficienti i subjektit transmetues me mbulim lokal do të jetë i barabartë me 1.5 dhe

- Koeficienti i subjektit transmetues me mbulim nacional do të jetë i barabartë me 2.

Neni 16.1 i Ligjit të KPM-së thotë:

“Me rekomandimin e Shefit Ekzekutiv, Këshilli cakton një skemë për tarifat e licencës, për kategori të ndryshme të licencave të transmetimit që do të paguhen për çdo vit nga të licencuarit. Në caktimin e orarit, Zyra e Shefit Ekzekutiv i merr parasysh kushtet mbizotëruese dhe ato të projektuara të tregut. Tarifa e licencës do të jetë e njëjtë në kuadër të çdo kategori të licencave. Orari i tarifave i paraqitet Këshillit për aprovim”.

KPM ka licencuar subjektet transmetuese, radio dhe TV, në tri kategorji:

- me fuqi të ulët (50 Watts ERP për radio dhe televizion);
- lokale (1 KW ERP për radio dhe 5 KW ERP për televizion); dhe
- nationale (radiot dhe TV që janë të licencuara në frekuencat nacionale të përcaktuara sipas ITU; për pozitat e regjistruara si pikat transmetimi nacional po ashtu sipas ITU-së).

Për të përbushur obligimin ligor që del nga Neni 16 i Ligjit të KPM-së, pas kalkulimit të shumave individuale është bërë ndarja sipas kategorive, me çka është bërë kalkulim sipas të cilët janë nxjerrë shumat e taksës së vetme vjetore për kategoritë nacionale, lokale dhe me fuqi të ulët (veç e veç për radio dhe televizion).

Më saktësisht: është bërë kategorizimi i subjekteve transmetuese dhe është mbledhur totali i shumës vjetore për secilën kategori veç e veç dhe në fund mesatarja e shumës së përgjithshme për secilën kategori është marrë për bazë për caktimin e nivelit të taksës.

KPM ka arritur të përcaktojë tarifat vjetore të njëjta të licencës për secilën kategori të subjekteve transmetuese. Tarifa Vjetore është përcaktuar për radio dhe TV me fuqi të ulët, radio dhe TV lokale dhe radio e TV nacionale.

Kategoria	Tarifa Vjetore
16 / Radio me fuqi të ulët	135 €
2 / TV me fuqi të ulët	385 €
73 / Radio lokale	395 €
15/ TV lokale	650 €
4 / Radio nacionale	7752 €
3 / TV nacionale	11628 €

E – koeficienti i zbritjes për mediat minoritare

Mediat minoritare do të kenë zbritje prej 10% nga taksa e përgjithshme vjetore e përcaktuar me këtë vendim.

Neni 6

Mënyra e pagesës së taksës

- 6.1. Taksa Vjetore për licencë do të depozitohet në tërësi në llogarinë bankare të Komisionit të Pavarur për Media.
- 6.2. Taksat Vjetore për lëshimin e licencës për transmetim të sinjaleve radio dhe televizive do të paguhen në llogarinë bankare të Komisionit të Pavarur për Media jo më vonë se data 5 e muajit aktual.
- 6.3. Në rast se subjektet transmetuese nuk e informojnë Komisionin e Pavarur për Media se nuk planifikojnë të transmetojnë program më tutje, përgjegjësitë e ndërmarra financiare nga licenca do të jenë të vlefshme nga momenti i pranimit të njoftimit me shkrim.
- 6.4. Nëse mbajtësi i licencës ndalon së transmetuari sinjalet e radios dhe televizionit para skadimit të kohës për të cilën kohë taksa është paguar, një pjesë e taksës që i referohet kohës së mbetur nuk do të rimbushet.
- 6.5. Nëse është vendosur se i licencuari ka transmetuar jashtë zonës së mbulimit të caktuar në licencën e tij, KPM retro-aktivisht mund t'i caktojë të licencuarit (dyfish) vlerën e taksës që ai do të paguante për zonën e tij të pa-licencuar nëse ai mbulim i zonës do të përcaktohej në licencën e tij. Kjo pagesë është si shtesë e çdo sanksioni që KPM mund të vendosë.
- 6.6. Në rast të pagesës së taksës me vonesë, e referuar në paragrafin 2 të këtij neni, personi me licencën e lëshuar për transmetim të sinjaleve të radios dhe televizionit do të paguajë kamatë për vonesë të pagimit të taksës.
- 6.7. Niveli i kamatës do të caktohet sipas nivelit të kamatës që e aplikon Administrata Tatimore e Kosovës për vonesa në pagimin e tatimit.
- 6.7. Mospagimi i taksës së licencës do të rezultojë në sanksionimin e subjektit transmetues në pajtim me Ligjin dhe Rregulloret e KPM-së. Sanksionimi mund të rezultojë në revokimin e licencës.

Neni 7

Vlefshmëria e vendimit

Kjo metodë e përcaktimit të taksës për licencë do të vlejë vetëm për periudhën kohore deri sa subjektet transmetuese operojnë në bazë të licencës së përkohshme të KPM-së. Sipas Ligjit të KPM-së, Nenit 16.2, Zyra e Shefit Ekzekutiv e rishikon dhe mund të bëjë ndryshime në orarin e tarifave të licencave çdo dy (2) vjet.

Neni 8

Dispozitë kalimtare

Subjektet transmetuese taksën për licencë për vitin 2008, do të paguajn për periudhën prej 1 gusht 2008 deri më 31 dhjetor 2008. Ndërsa pas kësaj takse të parë për licencë, do të paguajnë taksën për licencë në pajtueshmëri me nenin 6.2 të këtij vendimi.


Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi më 21 korrik 2008.


Argjentina Grazhdani
Kryetare e Këshillit të KPM-së




21/07/2008
Datë